



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1192 prot.

Tiranë, më 12. 08. 2021

### V E N D I M

**Nr. 152, datë 12. 08. 2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) mori në shqyrtim ankesën nr. 136, datë 27.07.2021, të Shoqatës “Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri<sup>1</sup>”, kundër Televizionit Top-Channel dhe M. Ç., në cilësinë e Përgjegjësit të Zyrës së Katekizmit në Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, në të cilën pretendohet për diskriminim të Dëshmitarëve të Jehovahit, për shkak të “*bindjes fetare*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I :

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Shoqata “Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri”, është një organizatë fetare, e miratuar si e tillë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me Urdhrin nr. 100, datë 22.05.1992 dhe regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 6087, datë 13.08.1993.

Sipas subjektit ankues, Shoqata “Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri” është enti ligjor që përfaqëson bashkësinë fetare të Dëshmitarëve të Jehovahit që jetojnë në Shqipëri. Për qëllimet e kësaj ankese, ajo gjithashtu përfaqëson të gjithë Dëshmitarët e Jehovahit që jetojnë në Shqipëri për të mbrojtur “nderin” dhe “dinjitetin” dhe të drejtat e tyre të garantuara nga Nenet 8 dhe 9, të marra me vete dhe në lidhje me Nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Përfaqësuar pranë KMD-së nga z. A.V, me pozicion Zv/President i Shoqatës “Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri”.

<sup>2</sup> Në çështjen Metropolitan Church of Bessarabia and Others v. Moldova, Nr. 45701/99, 13 dhjetor 2001, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (me tej “GJEDNJ”) vendosi te § 101: “Gjykata thekson në fillim se një Kishë ose organizëm kishtar mund të ushtrojë, si i tillë, në emër të përkrahësve të tij të drejtat e garantuara në nenin 9 të Konventës.” [Shikoni gjithashtu Association of Jehovah’s Witnesses v. France (Association les Témoins de Jehovah v. France), Aplikimi nr. 8916/05, § 51,30 qershor 2011.]

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: “Në datë 3 qershor 2021, gjatë emisionit<sup>3</sup> ‘Shqipëria Live’ në Top Channel u diskutua rreth sekteve dhe kulteve satanike. Gjatë emisionit diskutimi i mëposhtëm u zhvillua midis M. Ç. dhe drejtuesit të emisionit, duke cituar si më poshtë vijon:

M. Ç.: Ti ke sekte sot, grupe fetare, të cilat thonë: mos ndero flamurin, mos shko ushtar, mos jep gjak. Si e lejon këtë sekt ti të lëvrojë hapur.

Gazetarja: Po, po flisni për Dëshmitarët e Jehovahit?

M. Ç.: ‘Po pra Dëshmitarët e Jehovahit.’

Gazetarja: ‘Ok.’

M. Ç.: ‘Ty si qytetar të thonë mos e ndero atdheun tënd, mos e mbro atdheun tënd.’

Gazetarja: ‘Dhe duhet të ishin të shpallehin të jashtëligjshëm?’

M. Ç.: ‘Për të shpëtuar jetën.’

Gazetarja E. R.: ‘Do duhet të shpallehin të jashtëligjshëm Dëshmitarët e Jehovahit?’

M. Ç.: ‘Patjetër në vende të ndryshme janë shpallur të paligjshëm.’

Gazetarja E. R.: ‘Dhe mendoni që kjo duhet të ndodhë dhe në Shqipëri?’

M. Ç.: ‘Po patjetër! Se ata dinë shumë më pak se neve’”.

Në vijim subjekti ankues sqaron se: “M. Ç. etiketoi Dëshmitarët e Jehovahit si një sekt të rrezikshëm, duke shtrembëruar bindjet tona dhe bën thirrje për ndalimin e aktivitetit tonë. Nga ana tjetër, gazetarja e emisionit e inkurajoi më tej këtë qëndrim diskriminues ndaj besimit tonë fetar, duke sugjeruar me pyetjet e saj të përsëritura ndalimin e aktivitetit tonë fetar.

Përveç kësaj, vetë Top Channel zgjodhi pohimin e M. Ç., duke paraqitur me nëntituj në faqen e saj zyrtare në web dhe në YouTube, i cili ka rreth 1.7 milion abonentë, deklaratën e tij: ‘Teologu M. Ç.: Dëshmitarët e Jehovahit duhet të shpallen të paligjshëm’.

Nuk është hera e parë që televizioni Top Channel sulmon organizatën tonë fetare, me mjetet që ka në dispozicion. Në shkelje flagrante të një gazetarie profesionale, ka vazhduar të shpifë dhe stigmatizojë organizatën tonë me programe televizive dhe artikuj në faqen web; të cilat cenojnë jo vetëm reputacionin e Dëshmitarëve të Jehovahit por edhe të drejtën e tyre për ushtrimin e lirë të besimit fetar.

Gjithashtu, M. Ç., si gjatë këtij emisioni, edhe me herët, në rastin e ngjarjes tragjike të ndodhur në Kombinat më 2 korrik 2020, ka sulmuar<sup>4</sup> drejtpërdrejtë organizatën tonë dhe bindjet e saj fetare duke nxitur urrejtje kundër Dëshmitarëve të Jehovahit, duke theksuar se: ‘Dëshmitarët e Jehovahit’ s’janë të krishterë, nuk duhet besuar kush vjen në derë’”.

Në përfundim të ankesës subjekti ankues theksoi se: “Kjo është e dukshme, veçanërisht në funksion të sa vijon:

<sup>3</sup>(shih linkun: <https://top-channel.tv/video/teologu-cakodeshmitaret-e-jehovajt-duhet-te-shpallen-te-paligjshem-shqiperia-live-3-qershor-2021/> min. 4:56-05:22)

<sup>4</sup> <https://abcnews.al/m.-c.-deshmitaret-e-jehovait-sjane-te-krishtere-nuk-duhet-besuar-kush-vjen-ne-dere/>

- Tema e emisionit ishte: ‘Kultet satanike dhe sektet e rrezikshme’, dhe Dëshmitarët e Jehovahit u përmendën në atë kontekst shumë negativ. Dëshmitarët e Jehovahit nuk kanë asnjë lidhje me satanizmin ose kultet satanike.
- Një i ftuar në emision i përshkroi qartësisht Dëshmitarët e Jehovahit si një sekt i rrezikshëm dhe i paligjshëm, bindjet dhe praktiket e të cilit duhet të ndalohen në vend.
- I ftuari në emisionit nuk ishte thjeshtë një person i zakonshëm. Deklaratat e tij, duke qenë nën tagrin e tij si përfaqësues i një komuniteti të madh fetar në vend, mund të kenë një ndikim më të madh në audiencën e programit.
- I ftuari shtrembëroi bindjet dhe praktiket e Dëshmitarëve të Jehovahit dhe deklaroi në mënyrë të rreme se aktivitetet e Dëshmitarëve të Jehovahit janë ndaluar në “vende të ndryshme”.
- Drejtuesja e emisionit jo vetëm që nuk arriti të ndalonte përshkrimin e Dëshmitarëve të Jehovahit si një kult të rrezikshëm, por gjithashtu e inkurajoi atë me pyetjet e saj të përsëritura.
- Pas transmetimit të emisionit, Top Channel reklamoi më tej deklaratat e M. Ç. duke postuar një artikull në internet në faqen e saj zyrtare dhe një video në kanalën e saj zyrtar në YouTube, me titull ‘Teologu M. Ç.: Dëshmitarët e Jehovahit duhet të shpallen të paligjshëm’.

Për më tepër, komentet e njerëzve që reagojnë ndaj videos në YouTube dhe artikullit në internet tregojnë qartë frymën e intolerancës fetare dhe diskriminimit që është nxitur. Më poshtë është një shembull i këtyre komenteve urryese:

B. C.: ‘Dëshmitarët e Jehovahit janë si terroristët ata duhet të kapen dhe të burgosen përjetë.’.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- shqyrtimin e ankesës dhe konstatimin e diskriminimit nga ana e televizionit Top-Channel dhe M. Ç.;
- vendimi përfundimtar të publikohet në operatorët mediatik.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose

*preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Për sa më lart, për të vijuar me verifikimin e fakteve të pretenduara nga subjekti ankues, lidhur me diskriminimin e Dëshmitarëve të Jehovait që jetojnë në Shqipëri, përmes termave të përdorur nga M. Ç., si dhe qëndrimin të mbajtur nga drejtuesja e emisionit dhe televizioni Top Channel, subjekti ankues i referohet emisionit *“Shqipëria Live”* të datës 03.06.2021, transmetuar në televizionin Top Channel.

Nga verifikimi rezultoi se, në datën 03.06.2021, në emisionin<sup>5</sup> *“Shqipëria Live”* në Top Channel, me temë: *“Sektet fetare dhe sataniste, një rrezik për shoqërinë tonë?”*. Një ndër të ftuarit në këtë emision ishte dhe M. Ç., në cilësinë e Përgjegjësit të Zyrës së Katekizmit në Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Gjatë emisionit ishte zhvilluar një diskutim midis M. Ç. dhe drejtueses së emisionit, si më poshtë vijon:

*M. Ç.: Ti ke sekte sot, grupe fetare, të cilat thonë: mos ndero flamurin, mos shko ushtar, mos jep gjak. Si e lejon këtë sekt ti të lëvrojë hapur’.*

*Gazetarja: Po, po flisni për Dëshmitarët e Jehovait?*

*M. Ç.: ‘Po pra Dëshmitarët e Jehovait.’*

*Gazetarja: ‘Ok.’*

*M. Ç.: ‘Ty si qytetar të thonë mos e ndero atdheun tënd, mos e mbro atdheun tënd.’*

*Gazetarja: ‘Dhe duhet të ishin të shpallehin të jashtëligjshëm?’*

*M. Ç.: ‘për të shpëtuar jetën.’*

---

<sup>5</sup>(shih linkun: <https://top-channel.tv/video/teologu-cakodeshmitaret-e-jehovajt-duhet-te-shpallen-te-paligjshem-shqipëria-live-3-qershor-2021/> min. 4:56-05:22)

*Gazetarja E. R.: 'Do duhet të shpalleshin të jashtëligjshëm Dëshmitarët e Jehovahit?'*

*M. Ç.: 'Patjetër në vende të ndryshme janë shpallur të paligjshëm.'*

*Gazetarja E. R.: 'Dhe mendoni që kjo duhet të ndodhë dhe në Shqipëri?'*

*M. Ç.: 'Po patjetër! Se ata dinë shumë më pak se neve'.*

Më pas, Top Channel kishte zgjedhur pohimin e M. Ç., duke paraqitur me nëntituj në faqen e saj zyrtare në web dhe në YouTube, deklaratën e tij: *'Teologu M. Ç., Dëshmitarët e Jehovahit duhet të shpallen të paligjshëm'*.

Në referim të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, vërehet se pretendimet e tij janë bazuar në faktin se e gjithë përmbajtja e diskutimeve të sipërcituara janë të rreme që nuk kanë lidhje me Dëshmitarët e Jehovahit, por që kanë patur si synim për shtrembëruar bindjet dhe sulmuar organizatën e tyre fetare. Gjithashtu, në pretendimet e subjektit ankues theksohet se ka një shkelje flagrante të një gazetarie profesionale, duke vazhduar të shpifë dhe stigmatizojë organizatën e tyre me programe televizive dhe artikuj në faqen web; të cilat cenojnë jo vetëm reputacionin e Dëshmitarëve të Jehovahit por edhe të drejtën e tyre për ushtrimin e lirë të besimit fetar.

Referuar për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se përdorimi i gjuhës fyese dhe shpifja parashikohen si vepra penale në nenin 119 dhe 120 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, të ndryshuar.

Në nenin 119 parashikohet se: *"Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë"*.

Në nenin 120 parashikohet se: *"Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që çenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë"*.

Lidhur me sa më sipër, palët kanë të drejtë për të kërkuar dhe shpërblimin e dëmit konform nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me ankesën e bërë nga subjekti ankues për sa i përket "shpifjes" nga ana e M. Ç., drejtueses së emisionit *"Shqipëria Live"* dhe televizionit Top Channel, Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10 221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10 21/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 32, pika 1/b, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës së Shoqatës “Dëshmitarët e Jehovait në Shqipëri<sup>6</sup>”, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni e këtij vendimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindjet fetare)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)

---

<sup>6</sup> Përfaqësuar pranë KMD-së nga z. A.V, me pozicion Zv/President i Shoqatës “Dëshmitarët e Jehovait në Shqipëri”.